

**PROJEKTLIGJ I PROPOZUAR PËR SHQIPËRINË**  
**“PËR DËFTESAT TREGTARE MBI PRODUKTET BUJQËSORE”**

**PROJEKTLIGJ**  
**“PËR DËFTESAT TREGTARE MBI PRODUKTET BUJQËSORE”**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

**Objekti**

Ky ligj përcakton rregullat mbi dëftesat tregtare për produktet bujqësore, të ardhshme dhe ato të magazinuara, si instrumente financiare, të garantuara me barrë siguroese, procedurat e regjistrimit, si dhe mënyrën e përmbushjes dhe të ekzekutimit të tyre.

Neni 2

**Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është që të nxisë financimet në bujqësi, pagesa të shpejta dhe të drejta për fermerin, si dhe krijimin e një sistemi kolaterali të produktit bujqësor të ardhshëm apo të magazinuar.

Neni 3

**Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **Ceduesi i një dëftese tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm apo të magazinuar** është personi fizik apo juridik, që tregon një dëftesë tregtare;
2. **Cesionari** është personi fizik apo juridik, që ka blerë një dëftesë tregtare;

3. **Debitori në dëftesën tregtare mbi produktin bujqësor, të ardhshëm** është fermeri, që me produktin bujqësor të kultivuar merr përsipër të shlyejë kreditorin, duke i kthyer shumën e detyruar apo dhënë në shkëmbim produkte bujqësore;
4. **Debitori në dëftesën tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar** është depozituesi, që ka depozituar produktet bujqësore në magazinë dhe e përdor dëftesën tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar, për ta tregtuar apo si garanci për kontratën e kredisë;
5. **Dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor, të ardhshëm** është instrument financiar, si titull i transferueshëm, në kuptimin e ligjit nr. 62/ 2020 “Për tregjet e kapitalit”, që përcakton detyrimin e pakushtëzuar të debitorit për t’i lëvruar kreditorit, produktin bujqësor ose pagesën e siguruar nga një produkt bujqësor, e regjistruar në regjistrin elektronik, me barrë siguroese dhe që përbën titull ekzekutiv;
6. **Dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar** është instrument financiar, si titull i transferueshëm, në kuptimin e ligjit nr. 62/ 2020 “Për tregjet e kapitalit”, që përbën titull ekzekutiv, e regjistruar në regjistrin elektronik, me barrë siguroese, kur përdoret si mjet për të garantuar përmbushjen e një detyrimi, të marrë nga debitori;
7. **Fermeri** është personi fizik apo juridik ose i pajisur me NUIS apo kartë fermeri, që ushtron veprimtari bujqësore;
8. **Kreditori në dëftesën tregtare mbi produktin bujqësor** është personi fizik apo juridik, që ofron fonde, shërbime, lëvron lëndë të para, mallra, për debitorin dhe ka të drejtë të marrë pagesën apo produktet bujqësore, siç përcaktohet në dëftesë;
9. **Magazinuesi i produkteve bujqësore** është subjekti që ushtron veprimatrinë, si operator i biznesit ushqimor;
10. **Periudha e tregtimit** përfshin kohën ndërmjet ditës së parë të muajit të shitjes (tregtimit) të një produkti bujqësor (kulture) të parashikuar në dëftesën tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm ose ndonjë produkti të së njëjtës kategori dhe ditës së fundit të muajit që i paraprin muajit të shitjes së produktit të së njëjtës kategori, që duhet korrur (kositur) gjatë stinës pasuese ose në çfarëdo momenti specifik, siç kanë rënë dakord kreditori dhe debitori.
11. **Produkt bujqësor** ka kuptimin e dhënë në ligjin nr. 9817, datë 22. 10. 2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural;
12. **Regjistri elektronik i dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore** është sistemi i informacionit të unifikuar, në platformën e-Albania, që përmban të dhëna elektronike, të detyrueshme për dëftesat tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm dhe atë të magazinuar.
13. **Regjistri elektronik i barrëve siguroese mbi produktet bujqësore** është sistemi i informacionit, në platformën e-Albania ku regjistrohen si barrë siguroese dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore.

## **KREU II**

### **DËFTESAT TREGTARE MBI PRODUKTIN BUJQËSOR TË ARDHSHËM**

#### Neni 4

#### **Lëshimi i dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm**

1. Fermeri ka të drejtë të lëshojë dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor, të ardhshëm, që kultivohet prej tij. Në rast lëshimi dëftesash tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm ai njofton çdo vit në formë elektronike Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare se po përdor këtë përjashtim.
2. Nëse sipërfaqja e tokës bujqësore, objekt kontrate është në bashkëpronësi, kontrata e dhënies në përdorim për qëllime të kultivimit bujqësor të tokës apo dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm duhet nënshkruar nga të gjithë bashkëpronarët, ose të paktën nga shumica e bashkëpronarëve, që kanë në pronësi më shumë se gjysmën e vlerës së sipërfaqes së tokës bujqësore, sipas përcaktimeve në Kodin Civil.
3. Transferimi i titullit të pronësisë ose i së drejtës së përdorimit të tokës nuk e shuan detyrimin për korrjet e ardhshme në dëftesën tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm dhe as nuk i shuan të drejtat e debitorit dhe të kreditorit të dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm për ta përdorur tokën deri në korrje, por jo më vonë se deri në fund të periudhës së tregtimit.
4. Debitori i dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm njofton subjektet te të cilët e transferon titullin e pronësisë ose të drejtën e përdorimit të tokës ku kultivohen produktet bujqësore të premtuara në dëftesë, për detyrimet ekzistuese që rrjedhin prej saj.
5. Format i tip të dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor, të ardhshëm, procedura elektronike e lëshimit dhe regjistrimit të saj në regjistrin elektronik të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore, si dhe në regjistrin elektronik të barrëve siguroese mbi produktet bujqësore miratohet me Urdhër të Ministrit.
6. Format i tip të kontratës elektronike, të dhënies në përdorim të tokës bujqësore miratohet me Urdhër të Ministrit.

#### Neni 5

#### **Elementët e dëftesës tregtare me shkëmbim në prodhim**

1. Dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm, me shkëmbim në prodhim lëshohet nga fermeri, kur ai nuk e shlyen dot menjëherë detyrimin që ka ndaj kreditorit. Dëftesat tregtare përmban elementet e detyrueshme, si më poshtë:
  - a) Titullin "Dëftesë tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm, me shkëmbim në prodhim";
  - b) Informacionet identifikuese për debitorin dhe kreditorin;

- c) Objektin (detyrimin kryesor): produktin bujqësor që duhet të lëvrohet nga debitori pa rezerva, cilësinë dhe sasinë e prodhimit. Në rast se lëvrohet një lloj dhe cilësi e ndryshme produkti bujqësor, kushtet dhe afatet për të përcaktuar shumën e detyrimit në një datë të caktuar dhe sasinë e produktit bujqësor të lëvruar në lloj dhe cilësi të ndryshme;
  - d) Afatin e përmbushjes së detyrimit dhe/ose afatin e shlyerjes së çdo kësti, nëse detyrimi duhet të përmbushet me këste;
  - e) Kushtet e përgjithshme dhe destinacioni për lëvrimin e produktit bujqësor;
  - f) Përshkrimin e objektit të premtimit, duke përfshirë llojet, sasinë, vlerën e produktit bujqësor, vendndodhjen ekzistuese (dhe të ardhshme) të produktit bujqësor (ku përfshihen prodhimet bimore dhe shtazore dhe përpunimin e parë), dokumentet që vërtetojnë të dhënat kadastrale të tokës dhe që certifikojnë pronësinë ose të drejtat e posedimit të tokës;
  - g) Informacion nëse ka kontratë sigurimi, që mbulon objektin e dëftesës;
  - h) Kërkesat thelbësore teknologjike për rritjen ose përpunimin parësor të produktit bujqësor;
  - i) Metodatat e tjera, përfshirë gjobat, të identifikuara për përmbushjen e detyrimit kryesor;
  - j) Ciklin e tregimit;
  - k) Datën dhe vendin e lëshimit të dëftesës.
2. Nëse janë dy ose më shumë debitorë, duhet të përfshihen të dhënat e të gjithë debitorëve.
  3. Debitori dhe kreditori mund të bien dakord për të përfshirë kushte shtesë, në një aneks të dëftesës tregtare, që i bashkëlidhet formatit tip, që plotësohet dhe pranohet online në platformën e- Albania, me kusht që ato të mos bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.
  4. Dëftesa tregtare që nuk plotëson parashikimet e këtij neni konsiderohet absolutisht e pavlefshme.

## Neni 6

### **Elementët e dëftesës tregtare me kthim shume**

1. Dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm, me kthim shume lëshohet nga fermeri, kur ai nuk e shlyen dot menjëherë detyrimin që ka ndaj kreditorit. Dëftesa tregtare përmbushet me kryerjen e pagesës në llogarinë bankare të kreditorit, apo me pagesën me para në dorë, brenda kufirit të lejuar me ligjin nr. 9920, datë 19. 05. 2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm, me kthim shume përmban elementët e detyrueshëm si më poshtë:
  - a) Titullin "Dëftesë tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm, me kthim shume";
  - b) Informacionet identifikuese për debitorin dhe kreditorin;

- c) Objektin (detyrimin kryesor dhe interesat): kushtet e përgjithshme për të përcaktuar shumën e parave që duhet t'i paguhet kreditorit, pa asnjë rezervë dhe, në rastet kur detyrimi duhet të paguhet me këste, kushtet që mundësojnë identifikimin e shumave përkatëse dhe afatet kohore, nisur nga çmimi i produkteve bujqësore sipas sasisë dhe cilësisë së specifikuar;
  - d) Afatin e përmbushjes së detyrimit sipas dëftesës tregtare të produktit bujqësor të ardhshëm me kthim shume ose afatin e shlyerjes së çdo kësti, nëse detyrimi duhet të përmbushet me këste;
  - e) Përshkrimin e objektit të kësaj dëftese, duke përfshirë artikujt (llojet), sasinë, vlerën e produktit bujqësor, vendndodhjen ekzistuese (dhe të ardhshme) të produktit bujqësor (ku përfshihen prodhimet bimore dhe shtazore dhe përpunimi i parë ushqimor) dhe dokumentet që vërtetojnë të dhënat kadastrale të tokës dhe që certifikojnë pronësinë ose të drejtat e posedimit të tokës në vendndodhjen e saj;
  - f) Informacion nëse ka kontratë sigurimi, që mbulon objektin e dëftesës;
  - g) Kërkesat thelbësore teknologjike për rritjen ose përpunimin parësor të produktit bujqësor;
  - h) Mënyrat e tjera, përfshirë gjobat, të identifikuara për përmbushjen e detyrimit kryesor;
  - i) Datën dhe vendin e lëshimit.
3. Nëse janë dy ose më shumë debitorë, duhet të përfshihen të dhënat e mësipërme të të gjithë debitorëve.
  4. Debitori dhe kreditori mund të përfshijnë kushte shtesë, në një aneks të dëftesës, që plotësohet dhe pranohet online në platformën e- Albania, me kusht që ato të mos bien në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.
  5. Dëftesa tregtare që nuk plotëson parashikimet e këtij neni konsiderohet absolutisht e pavlefshme.

#### Neni 7

### **Garancitë e dëftesës tregtare**

1. Dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm ka si kolateral vetë produktet bujqësore të përcaktuara në objektin e saj, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 6 të këtij neni.
2. Vlera e kolateralit të dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm nuk është më e vogël se detyrimi kryesor i parashikuar në të.
3. Debitori është përgjegjës të provojë origjinën e produkteve bujqësore të prodhuara ose të korrura, të cilat janë kolateral i dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm.
4. Kur për shkak të humbjes së produkteve bujqësore të rritura, të korrura dhe të përpunuara nuk është e mundur shlyerja e plotë e detyrimit sipas kësaj dëftese, debitori duhet ta zëvendësojë produktin bujqësor me një kolateral tjetër me të njëjtën vlerë, sipas marrëveshjes me shkrim me kreditorin, në aneksin e dëftesës tregtare.

5. Nëse debitori dhe kreditori nuk kanë përpiluar një aneks të tillë në fillim apo nuk arrijnë në një marrëveshje, korrjet e ardhshme të produktit bujqësor, nga toka që u përdor për të rritur, korrur dhe prodhuar këtë produkt do të konsiderohen kolateral i dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm deri në shlyerjen e plotë të detyrimit të parashikuar në të.
6. Në rast mos përmbushjeje detyrimi me kolateralin e përcaktuar në dëftesë, debitori, me pëlqimin e kreditorit ka të drejtë të përdorë një pasuri tjetër për përmbushjen e detyrimit.
7. Debitori ose kreditori kanë të drejtë të bëjnë kontratën e sigurimit të kolateralit të dëftesës tregtare ose vendosin t'i ndajnë bashkë shpenzimet e kësaj kontrate.

#### Neni 8

##### **Monitorimi i kolateralit**

1. Kreditori ka të drejtë ta monitorojë vetë ose duke përfshirë një palë të tretë, objektin e kolateralit gjatë vlefshmërisë së barrës siguroese, me kusht që debitori të njoftohet nga kreditori të paktën 3 (tri) ditë pune, para kryerjes së këtij monitorimi.
2. Monitorimi përmban vëzhgimin e objektit të kolateralit dhe informimin për proceset e tokës bujqësore, me strukturën e magazinimit, mjetet dhe vendet e tjera ku rritet (përgatitet) produkti bujqësor, që është objekt i përpunimit parësor dhe ku magazinohet ai.
3. Kreditori nuk ka të drejtë të ndërhyjë në veprimtarinë e biznesit të debitorit gjatë kryerjes së monitorimit.
4. Nëse gjatë monitorimit, kreditori zbulon shkelje që mund të ngrenë dyshime të arsyeshme për sasi dhe cilësi të papërshtatshme të produktit bujqësor, si rezultat i kultivimit ose mbarështimit, magazinimit, transportit dhe përpunimit parësor, ai njofton me shkrim debitorin për këto shkelje dhe përcakton afatin kohor për t'i eliminuar ato.
5. Në rastet kur debitori nuk arrin t'i eliminojë shkeljet brenda afatit të parashikuar nga pika 4 e këtij neni, kreditori mund t'i kërkojë përmbushjen e parakohshme të detyrimit ose të zbatojë mekanizmin e parashikuar në nenin 21, të këtij ligji për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje.
6. Në rast se shkeljet ekzistojnë dhe kultivimi, mbarështimi, magazinimi, transporti dhe përpunimi parësor i produktit bujqësor do të vazhdohet nga kreditori, debitori është i detyruar t'i mbulojë shpenzimet shtesë me të cilat do të përballet kreditori.

#### Neni 9

##### **Tregtimi i dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm**

1. Kreditori ka të drejtë t'ia shesë një të treti dëftesën tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm, drejtëpërdrejt, kur është në kushtet e përjashtimit nga ligji “Për tregjet e kapitalit”, ose duke ndjekur procedurat e përcaktuara në ligjin “Për tregjet e kapitalit”.

2. Debitori mund t'ia kalojë detyrimin e tij një të treti, me pëlqimin e kreditorit.
3. Pasqyrimet në regjistrin elektronik të dëftesave tregtare dhe në regjistrin elektronik të barrëve siguroese mbi produktet bujqësore kryhen nëpërmjet aplikimit të dy regjistrat respektivë nga subjekti që ka filluar transaksionin.
4. Kontratat tip, për tregtimin e dëftesave tregtare miratohen me Urdhër të Ministrit.

### KREU III

## **DËFTESA TREGTARE MBI PRODUKTIN BUJQËSOR TË MAGAZINUAR**

### Neni 10

#### **Kushtet e lëshimit të dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar**

1. Magazinuesi, me kërkesën e depozituesit lëshon një dëftesë tregtare mbi produktin bujqësor, që ka pranuar ta magazinojë, në kushte të caktuara, si dhe t'i lëvrojë këto produkte me kërkesën e depozituesit, ndërsa depozituesi është i detyruar t'i paguajë magazinuesit shpërblimin e caktuar, për shërbimin e kryer.
2. Magazinuesi ia dorëzon produktet bujqësore depozituesit ose kreditorit të depozituesit, sipas kontratës mes këtyre të dyve.
3. Në çastin e depozitimit të produkteve bujqësore, magazinuesi me pëlqimin e depozituesit, veçon një sasi produktesh bujqësore nga ato të lëna në ruajtje, me vlerë sa shpërblimi i magazinimit, si garanci për pagesën, që duhet t'i kryhet. Nëse depozituesi nuk arrin t'ia kryejë pagesën konform kontratës së magazinimit, magazinuesi i merr në pronësinë e tij sasinë e produkteve bujqësore të veçuara si garanci. Sasia e produkteve bujqësore të veçuara për të garantuar pagesën e magazinuesit nuk përfshihet te produktet e lëna si kolateral.

### Neni 11

#### **Elementët e dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar**

1. Dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar përdoret nga depozituesi i produkteve bujqësore për të tregtuar produktet e tij ose për të siguruar financim duke i lënë këto produkte bujqësore si kolateral.
2. Dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar përmban elementët e mëposhtëm:
  - a) Identifikimin e depozituesit dhe të magazinuesit;
  - b) Vendodhjen e magazinës;
  - c) Llojin, natyrën dhe sasinë e produkteve bujqësore të depozituara;
  - d) Informacionin për masën në të cilën mallrat janë dorëzuar, të dhënat e tjera të nevojshme për njohjen e mallrave dhe përcaktimin e vlerës së tyre. Bashkëlidhur kopjen e fletës së hyrjes së magazinës.



3. Kur depozituesi i shet produktet e tij bujqësore i mjafton si dokument provues dëftesa tregtare mbi produktet bujqësore të magazinuara. Nëse depozituesi merr kredi, dëftesa tregtare mbi produktet bujqësore shërben si garanci për kredidhënësi për shlyerjen e detyrimit dhe regjistrohet si e tillë në regjistrin elektronik të barrëve siguruese mbi produktet bujqësore.
4. Format i tip të dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar, procedurën elektronike të lëshimit, të regjistrimit në regjistrin elektronik të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore, si dhe në regjistrin e barrëve siguruese mbi produktet bujqësore miratohet me Urdhër të Ministrit.

## Neni 12

### **Të drejtat e depozituesit**

1. Depozituesi ka të drejtë t'i kërkojë magazinuesit t'i ndajë produktet bujqësore në disa pjesë dhe të lëshojë fletë hyrje magazine të veçanta, apo dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar për secilën pjesë.
2. Nëse është lëshuar një dëftesë tregtare për të gjithë sasinë e produkteve bujqësore, depozituesi ka të drejtë t'i kërkojë magazinuesit t'i ndajë produktet bujqësore në disa pjesë dhe në këmbim të dëftesës bazë, të lëshojë dëftesa për secilën pjesë më vete.
3. Depozituesi ka të drejtë t'i kërkojë magazinuesit të përpilojë me të dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar vetëm për një pjesë të produkteve të barazndërrueshme, që depozituesi ka depozituar.
4. Depozituesi apo kreditori ka të drejtë të kërkojë, që produktet e shënuara në të, t'i lëvrohen në çdo moment.
5. Gjatë dorëzimit të produkteve bujqësore te magazinuesi, depozituesi i jep atij të gjitha informacionet e nevojshme për këto produkte dhe i deklaron vlerën e tyre.
6. Magazinuesi nuk mund të përziejë produktet e barasndërrueshme, që ka marrë me produkte të të njëjtit lloj dhe cilësi, me përjashtim të rastit kur depozituesi i ka dhënë miratimin për një veprim të tillë ose nëse është e qartë se produktet mund të përzihen, pa rrezikuar t'i shkaktojnë dëm depozituesit.
7. Nëse produktet përzihen, magazinuesi, me kërkesën e njërit depozitues, mund të ndajë më vete pjesën e tij.

### Neni 13

#### **Garancitë ndaj kreditorit dhe cesionarit**

1. Kreditori apo cesionari i dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar, të cilit nuk i është paguar shuma e siguruar me barrë siguroese brenda afatit, ka të drejtë të kërkojë pagesën nga depozituesi i produkteve, përndryshe ky i fundit humbet të drejtën e pronësisë mbi produktet bujqësore të magazinuara.
2. Depozituesi detyrohet që brenda 8 (tetë) ditëve të kryejë pagesën sipas pikës 1 të këtij neni ose në të kundërt kreditori apo cesionari ka të drejtë të kërkojë shitjen e produkteve bujqësore të lëna si barrë siguroese.
3. Nga shuma e siguruar nga shitja, zbritet shuma e nevojshme për të mbuluar koston e shitjes, shumën e detyruar në favor të magazinuesit, nëse magazinuesi nuk e ka marrë paraprakisht shpërblimin e tij, detyrimet e tjera të krijuara nga shitja e produkteve dhe më pas shlyhet detyrimi ndaj kreditorit apo cesionarit të dëftesës, ndërsa pjesa e mbetur i kalon depozituesit të produkteve bujqësore të magazinuara.
4. Kreditori ka të drejtë t'ia transferojë dëftesën tregtare një të treti, që konsiderohet cesionar i dëftesës dhe ky i fundit ta transferojë sërish duke zbatuar rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 62/ 2020 “Për tregjet e kapitalit”, për subjektet që kanë të drejtë t'i tregtojnë këto instrumente financiare.

### Neni 14

#### **Kërkesat e kreditorit apo të cesionarit për pagesë**

1. Kreditori apo cesionari mund të kërkojë pagesën nga depozituesi i dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar nëse nuk ka arkëtuar shumën e plotë të detyrimit, nga shitja si më lart e produkteve të lëna, si barrë siguroese.
2. Kërkesa nga kreditori apo cesionari duhet të paraqitet brenda afatit 7 (shtatë) ditor nga e nesërmja e marrjes dijani për mosshlyerjen e plotë të detyrimit me të ardhurat e arkëtuara nga shitja e produkteve të lëna si barrë siguroese.

### Neni 15

#### **Defektet gjatë marrjes në dorëzim të produkteve**

1. Magazinuesi duhet t'i kontrollojë produktet, në momentin e marrjes së tyre në dorëzim.
2. Për defektet gjatë marrjes në dorëzim të produkteve bujqësore zbatohen procedurat e parashikuara në Kodin Civil.

## Neni 16

### **Tregtimi i dëftesës tregtare mbi produktet e magazinuara**

1. Depozituesi i produkteve bujqësore ka të drejtë ta tregtojë dëftesën tregtare mbi produktet bujqësore të magazinuara dhe kontratën përkatëse duhet ta dërgojë për regjistrim në regjistrin elektronik të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore.
2. Depozituesi merr kredi duke lenë si garanci dëftesën tregtare mbi produktet bujqësore të magazinuara. Dëftesa tregtare mbi produktet bujqësore regjistrohet në regjistrin elektronik të barrëve siguruese mbi produktet bujqësore.
3. Kreditori apo cesionari, kur janë në kushtet e përjashtimeve të nenit 10, të ligjit nr. 62/2020 “Për tregjet e kapitalit” i tregëtojnë dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore të magazinuara, duke njoftuar çdo vit Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare se po përdorin këtë përjashtim, si dhe e dërgojnë kontratën e shitjes së dëftesës për regjistrim në regjistrin elektronik të dëftesave tregtare.
4. Kontratat tip, për tregtimin e dëftesave tregtare, që mund të përpilohen, online në sistemin elektronik të këtyre dëftesave miratohet me Urdhër të Ministrit.

## KREU IV

### **REGJISTRI ELEKTRONIK I DËFTESAVE TREGTARE MBI PRODUKTET BUJQËSORE**

## Neni 17

### **Krijimi i regjistrit elektronik i dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore**

1. Ministria është autoriteti kompetent për administrimin e regjistrit elektronik të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore. Regjistri është publik dhe pa pagesë.
2. Regjistri i elektronik i dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore krijohet dhe funksionon si sistem në platformën e-Albania. Të dhënat parësore hidhen në sistem nga njësia dhe të dhënat dytësore merren nga bazat e të dhënave në e-Albania. Subjektet e interesuara plotësojnë të dhënat e kërkuara, sipas aplikimit për dëftesat tregtare përkatëse.
3. Debitori i ngarkon të dhënat e dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm në regjistrin elektronik. Dokumenti elektronik i plotësuar prej tij kontrollohet nga njësia e regjistrit elektronik të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore, nëse i ka plotësuar të gjitha rubrikat e kërkuara, nëse nuk është i rënduar me barrë siguruese në sistem i njëjti produkt bujqësor, si dhe nëse ka ndonjë pasaktësi të dukshme e kur nuk konstaton të meta në këto aspekte, ia dërgon kreditorit për pranim elektronik. Procedura pezullohet derisa të vijë mesazhi i pranimit elektronik nga kreditori. Kreditori ka të drejtë të kryejë verifikimet faktike të të dhënave, që janë plotësuar në sistem dhe kur sigurohet se janë të sakta e të plota kryen pranimin elektronik të dëftesës. Pas pranimit elektronik nga ana e kreditorit njësia jua dërgon në mënyrë elektronike debitorit dhe kreditorit, një kopje të dëftesës tregtare, ku rezulton edhe pranimi elektronik, si dhe regjistrimi i kryer në

regjistrin elektronik dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore, dhe në regjistrin elektronik të barrëve siguruese.

4. Magazinuesi i ngarkon në sistem të dhënat e dëftesës tregtare mbi produktet e magazinuara. Njësia e regjistrit kontrollon nëse magazinuesi i ka plotësuar të gjitha rubrikat e përcaktuara dhe ia dërgon për pranim elektronik depozituesit të produkteve bujqësore. Pas pranimit elektronik nga depozituesi, njësia e regjistrit e regjistron në regjistrin elektronik të dëftesave tregtare dhe jua dërgon si magazinuesit dhe depozituesit dëftesën tregtare mbi produktet bujqësore të magazinuara. Depozituesi, kur nënshkruan një kontratë kredie me një subjekt dhe lë si garanci këtë dëftesë tregtare mbi produktet e magazinuara plotëson në sistem pjesën e përcaktuar për kreditim, duke vënë bashkëlidhur edhe kontratën e kredisë. Njësia e regjistrit verifikon nëse janë plotësuar të gjitha rubrikat, si dhe nëse nuk është i dërgon për miratim kreditorit. Me marrjen e miratimit nga kreditori, njësia e regjistrit e regjistron në regjistrin e barrëve siguruese dhe ia dërgon këtë dëftesë tregtare, të regjistruar me barrë siguruese, një kopje depozituesit, që është dhe debitor, kreditorit, si dhe magazinuesit, që ka lëshuar dëftesën.
5. Regjistrimi në regjistrin elektronik të dëftesave tregtare është kusht për vlefshmërinë e veprimit juridik.
6. Procedurën elektronike të lëshimit të dëftesave tregtare, mënyrën, afatet, të dhënat parësore dhe detyrësore, ndërveprimin me bazat e të dhënave të tjera, nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara si dhe rregulla të tjera në lidhje me funksionimin e këtij sistemi në platformën e-Albania miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

## Neni 18

### **Njësia e regjistrit elektronik të dëftesave tregtare**

1. Njësia e regjistrit elektronik të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore ngrihet dhe funksionon brenda strukturës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
2. Njësia e regjistrit elektronik të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore ka këto kompetenca:
  - a) ngarkon të dhënat në sistem për t'u plotësuar nga përdoruesit;
  - b) verifikon formalisht dhe përditëson të dhënat e plotësuara për dëftesat tregtare brenda 5 ditë punë, nga marrja e njoftimit elektronik;
  - c) kur konstatohet se regjistrimi nuk plotëson kërkesat formale aplikuesit i kërkohet të plotësojë mangësitë mangësitë brenda 10 ditë pune nga marrja e njoftimit;
  - ç) nëse mangësitë nuk plotësohen brenda afatit, aplikimi refuzohet dhe njoftohet aplikanti. Aplikanti mund të ankohet lidhur me refuzimin sipas kushteve dhe afateve të Kodit të Procedurës Administrative.
  - d) nëse mangësitë plotësohen, dhe pasi dëftesa tregtare është pranuar nga pala tjetër njësia përgjegjëse kryen regjistrimin në regjistrin elektronik të dëftesave tregtare dhe kur është rasti edhe në regjistrin elektronik të barrëve siguruese;

- dh) lëshon ekstrakte nga regjstri elektronik i dëftesave tregtare apo nga regjstri elektronik i barrëve siguruese, me kërkesën e të interesuarve;
- e) bashkëpunon rast pas rasti me AREBET për ushtrimin e monitorimit në terren, me kërkesë të depozituesit, kur ka arsye për të dyshuar mbi saktësinë e të dhënave apo kur e këtë e vlerëson të nevojshme;
- ë) njofton AKU-në për ushtrimin e monitorimit të magazinave gjatë magazinimit të produktit bujqësor objekt detyrimi i një dëftese tregëtare për magazinim;
- f) refuzon kërkesën për lëshimin e dëftesës tregëtare kur egziston dyshimi i arsyeshëm për keqpërdorim të të dhënave apo regjstrit elektronik;
- g) si dhe kryen çdo veprim tjetër për mirëfunksionimin e regjstrit elektronik të dëftesave tregtare, që mund t'i ngarkohet me vendim të Këshillit të Ministrave në zbatim të këtij ligji.

## Neni 19

### **Përmbajtja e regjstrit elektronik të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore**

1. Në regjistër duhet të përfshihen informacionet e mëposhtme:
  - a) identifikimi i kreditorit të dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm;
  - b) identifikimi i debitorit të dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm;
  - c) identifikimi i depozituesit të dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar;
  - d) identifikimi i magazinuesit të dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar;
  - e) identifikimi i ceduesit apo cesionarit të këtyre dëftesave tregtare;
  - f) përshkrimi i produkteve bujqësore dhe pronës sipas parashikimeve të këtij ligji.
2. Regjstri elektronik i dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore përmban informacion për:
  - a) personat e regjistruar si debitorë (fermerë);
  - b) personat e regjistruar si kreditorë;
  - c) informacione që përshkruajnë produktet bujqësore;
  - d) personat e regjistruar si depozitues;
  - e) personat e regjistruar si magazinues;
  - f) informacione për përdoruesit e regjstrit, si për ceduesit, cesionarët;
  - g) të dhëna statistikore për veprimtarinë e regjstrit;
  - h) skedarin e evidencës së të gjitha veprimeve në regjstrin e dëftesave tregtare.
3. Regjstri elektronik i dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore është pa pagesë dhe përdoruesit nuk paguajnë për asnjë prej shërbimeve të ofruara nga njësia e regjstrit elektronik të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore.

## Neni 20

### **Ndryshimi i dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore**

Dëftesat tregtare mbi produktin bujqësor, të ardhshëm dhe mbi produktin bujqësor të magazinuar mund të ndryshohen me të njëjtën procedurë, me të cilën janë lëshuar.

## Neni 21

### **Ruajtja e të dhënave**

1. Njësia e regjistrimit elektronik të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore ruan dhe mbron të dhënat e përfshira në aktet nën administrim të saj, duke mbrojtur të dhënat personale dhe ato që përbëjnë sekret tregtar.
2. Të dhënat e tjera, përveç të dhënave personale dhe atyre që përbëjnë sekret tregtar janë të përdorshme në përputhje me legjislacionin mbi të dhënat e hapura.

## KREU IV

### **PËRMBUSHJA E DETYRIMEVE DHE EKZEKUTIMI I DËFTESAVE TREGTARE MBI PRODUKTET BUJQËSORE**

## Neni 22

### **Përbushja e detyrimeve të dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm**

1. Detyrimi i marrë përsipër, në dëftesën tregtare mbi produktin bujqësor, të ardhshëm konsiderohet i përbushur me pagimin e shumës së parashikuar në të. Detyrimi i marrë përsipër me dëftesën tregtare mbi produktin bujqësor, të ardhshëm me shkëmbim në prodhim konsiderohet i përbushur duke dorëzuar produktin bujqësor te kreditori.
2. Nëse nuk vendoset ndryshe nga debitori dhe kreditori i dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm, lëvrimi i produktit bujqësor në lloj dhe cilësi të ndryshme nga ajo që është parashikuar në dëftesë nuk konsiderohet përbushje e detyrimit që buron prej saj.
3. Debitori dhe kreditori mund të arrijnë një marrëveshje për përbushjen e detyrimit të parashikuar, me lëvrimin e një produkti bujqësor të një lloji dhe cilësie të ndryshme ose me transferimin e shumës së deklaruar në llogarinë bankare të kreditorit.
4. Debitori dhe kreditori mund të arrijnë një marrëveshje për përbushjen e detyrimit të dëftesës tregtare duke i paraqitur kreditorit të kësaj dëftese, një dëftesë tregtare për produktin bujqësor të magazinuar të lëshuar nga magazinuesi, në magazinën e të cilit është magazinuar produkti për shkëmbim, në vend që t'i lëvrojë kreditorit produktin bujqësor të parashikuar në

dëftesën e parë. Dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm konsiderohet e shlyer dhe ky fakt pasqyrohet në regjistrin elektronik të dëftesave tregtare mbi produktin bujqësor.

5. Debitori dhe kreditori i dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm mund të arrijnë një marrëveshje për përmbushjen e parakohshme të detyrimit nga debitori.
6. Me përmbushjen e detyrimit, kreditori dhe debitori i dëftesës tregtare njofton, brenda 3 (tri) ditëve pune, për detyrimin e përmbushur dhe detyrimin e mbetur në regjistrin elektronik të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore.

#### Neni 23

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve të dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore**

1. Cilësia e produktit bujqësor, objekt i dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor, të ardhshëm, me shkëmbim në prodhim përcaktohet me mirëkuptim nga debitori dhe kreditori sipas standardeve, specifikimeve dhe rregulloreve teknike shtetërore në fuqi.
2. Kreditori që ka pretendime mbi cilësinë e produktit bujqësor ka të drejtë t'i kërkojë mendim përfaqësuesve të zyrës së ekstensionit bujqësor, ose një eksperti privat, nëse është përcaktuar paraprakisht në dëftesën tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm.
3. Mosmarrëveshjet ndërmjet debitorit dhe kreditorit apo secilit prej tyre dhe magazinuesit zgjidhen nëpërmjet një ndërmjetësi apo arbitrazhit, ose secila nga palët mund t'i drejtohet gjykatës kompetente.

#### Neni 24

### **Ekzekutimi i kolateralit**

1. Nëse nuk konfirmohet përmbushja e detyrimit që buron nga dëftesa tregtare në regjistrin elektronik të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore, kreditori ose cesionari kanë të drejtë të kërkojnë përmbushjen e detyrimit nga debitori, pa patur nevojë të paraqesin prova të tjera shtesë.
2. Mospërmbushja ose përmbushja e jo e plotë e detyrimit të dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm dhe i dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar mund të sjellë si pasojë ekzekutimin e kolateralit.
3. Ekzekutimi kryhet nga përbaruesi gjyqësor, sipas procedurës të parashikuar nga ligji nr. 8357, datë 18. 10. 1999 "Për barrët siguruuese", i ndryshuar.

KREU V  
**DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

Neni 25  
**Zbatimi i ligjeve të tjera**

Për çështjet e tjera, që nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj, gjejnë zbatim dispozitat e Kodit Civil.

Neni 26  
**Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave, që të miratojë brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, aktet nënligjore, që burojnë nga nenet 4, pikat 5 dhe 6, 9, pika 4, 10, pika 4, 11 pika 4, 16, pika 4, 17, pika 5 dhe 19, pika 4, të këtij ligji dhe të vërë në funksionim, në platformën e-Albania, regjistrin elektronik të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore dhe regjistrin elektronik të barrëve siguruese të produkteve bujqësore brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 27  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**LINDITA NIKOLLA**